



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900826/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Rekomandohet mbyllja e menjëherëshme I.E.V.P. Krujë, si dhe sistemimi i menjëhershëm i personave me probleme të shëndetit mendor që trajtohen në kundërshtim me ligjin në këtë institucion, në pavijone psikiatrike që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, deri në ngritjen e institucionit të posaçëm mjekësor sipas përcaktimit të ligjit nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor".*

Drejtuar: Znj. Etilda GJONAJ
Ministër i Drejtësisë

TIRANË

Znj. Ogerta MANASTIRLIU
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANË

Z. Agim ISMAILI
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Petrit MYSLYMI
Drejtor i I.E.V.P. Krujë

KRUJË

Për dijëni: Sh.T.Z. EDI RAMA
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

TIRANË

Të nderuar zonja/zotërinj,

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar¹, ka tërhequr në mënyrë të përsëritur vëmendjen për kushtet e trajtimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ku janë vendosur personat me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale. Moszbatimi i ligjit nr. 44/2012, datë 08.05.2012

¹ Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

“Për Shëndetin Mendor”, për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor me qëllim trajtimin e kësaj kategorie personash, ka sjellë problematikën e trajtimit të tyre në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, të cilat për më tepër gjenden në kushte mjaft të rënduara amortizimi e mbipopullimi. Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përsëritur u ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse mbylljen e I.E.V.P. Zahari, Krujë ku ata trajtohen më së shumti, dhe ka bërë thirrje për ngritjen e institucionit të veçantë të parashikuar me ligj. Deri në ngritjen e këtij institucioni, Avokatit të Popullit ka kërkuar përmbushjen e standardeve të kushteve materiale të këtyre mjediseve të lidhura drejtpërsëdrejti me investimet e pamjaftueshme, si dhe ofrimin e një shërbimi cilësor, që mundësohet pikësëpari me rritjen e numrit të punonjësve të stafeve mjekësore dhe atyre mbështetëse.

Kuadri ligjor e institucional

Në ligjin nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, në nenin 28, pika 1 përcaktohet se: *“Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion të posaçëm në bazë të nenit 239 të Kodit Procedurës Penale”*. Theksojmë se ligji nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.06.2012, nuk e kushtëzon zbatimin e dispozitave të tij me ndërtimin apo krijimin e institucioneve mjekësore të posaçme nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.

Në referim të dokumentit “Mbi Rregullat Evropiane të Burgut”, miratuar nga Këshilli i Evropës dhe deleguar për zbatim vendeve anëtare me rekomandimin Nr.87/3, të Këshillit të Ministrave, ndër të tjera në pikën 100.1 të tij, përcakton se: *“Personat që konstatohen me probleme të shëndetit mendor nuk duhet të mbahen në burg, por duhet të dërgohen sa më shpejtë që të jetë e mundur nga burgjet në vende të përshtatshme për këtë kategori personash”*.

Gjetjet gjatë inspektimeve në IEVP Krujë

Avokati i Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, inspektoi I.E.V.P. Krujë më datë 20.06.2019. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, z. Alfred Koçobashi, z. Besnik Deda, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar dhe znj. Alma Alibali, eksperte e jashtme me specialitet mjekësor psikiatër. Nga inspektimi rezultoi se institucioni nuk kishte kaluar në konservim; në të kundërt, u konstatua se gjendja ishte rënduar edhe më tej nga mbipopullimi i vazhdueshëm dhe mungesa e investimeve.

Në vijim të konstatimeve të bëra vazhdimisht, si dhe rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare të ngritura në mbështetje të Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues (si p.sh. Komitetit kundër Torturës të Këshillit të Evropës CPT), organizatave jofitimprurëse që operojnë në vend (p.sh. Komiteti Shqiptar i Helsinkit KSHH, Shoqata Përthyerje, etj.), I.E.V.P. Krujë vazhdon të mbetet në funksionim si Institucion i Veçantë

Shëndetësor, ndonëse nuk plotëson asnjë kriter apo standard për të funksionuar si i tillë. Urdhri Nr.8927² datë 27.09.2018 “Për Klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale” e ka klasifikuar Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Krujë, si “Institut i Veçantë” me seksion të posaçëm për të moshuar mbi 65 vjeç, me siguri të lartë dhe të zakonshme, një sektor të veçantë për të dënuarit me shqetësime psikike dhe të sëmurë të pamundur, me siguri të zakonshme, dhe ka urdhëruar kalimin e tij në konservim (mbyllje e përkohshme).

Referuar rekomandimeve të CPT-së³ dhe Avokatit të Popullit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në vitin 2018 u morr një vendim lidhur me zgjidhjen provizore të kësaj problematike, e cila nisi me rikonstruktimin dhe përshtatjen e dy godinave 4, 5 brenda IEVP-së Shën Koll, Lezhë, të cilat do të shërbejnë për akomodimin provizor të personave të trajtuar në IEVP Zahari, deri në ngritjen e institucionit të posaçëm të parashikuar me ligj.

Nisur nga situata e pandryshuar si dhe me shqetësimin, për të parë nga afër zbatimin ose jo të angazhimeve të marra nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me shkrim për zbatim të rekomandimeve të mëparshme, zhvilluan një vizitë tjetër inspektuese brenda 6 muajve nga inspektimi i mëparshëm, në dt 17 dhjetor 2019, për ndjekjen e problematikave në I.E.V.P. Zahari. Në përbërje të grupit inspektues ishin Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca, Komisionerja e MKPT-së znj. Ermonela Xhafa, këshilltarja znj. Jorida Rustemi, si dhe nd/komisionerja znj. Nertila Qafzezi. Gjatë takimit me drejtuesin e IEVP-së z. Petrit Myslymi, u rikonstatua se jo vetëm që situata infrastrukturore ishte në degradim, por kishte mbipopullim të konsiderueshëm, 100 persona mbi kapacitetin, madje pavarësisht disa masave për plotësimin e stafit, duhen marrë masat e duhura për rritjen e numrit të stafit për të përmbushur nevojat për siguri, për trajtim të përshtatshëm me kujdes shëndetësor e psiko-social. Pavarësisht punës me përkushtim të stafit aktual, ky institucion nuk plotëson asnjë standard për të funksionuar si i tillë.

Grupi inspektues, në po të njëjtën ditë, inspektoi dhe IEVP Shën Koll Lezhë, për të vlerësuar nga afër situatën, lidhur me punimet në godinat 4 dhe 5. Pas takimit me drejtuesin e institucionit dhe inspektimit në vend, u konstatua se punimet infrastrukturore të godinave ishin larg përmbushjes së afateve dhe përmbylljes, e për rrjedhojë të papërshtatshme për të filluar funksionimin. Një problematikë akoma e pazgjidhur është dhe përcaktimi i statusit të varësisë së këtyre dy godinave. A do të jenë nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, apo Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale, varësi nga e cila do të përcaktohet dhe plotësimi me staf, mjete pune, pajisje dhe objekte që mundësojnë jetesën me dinjitet të personave që do të trajtohen në to?⁴

² Urdhri i Ministrisë së Drejtësisë Nr.8927 datë 27.09.2018 “Për Klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”

³ Në raportin më të fundit të publikuar nga CPT mbi vizitën e kryer në nëntor të vitit 2018 [https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-në-përmbledhjen-ekzekutive-CPT/inf\(2019\)28](https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-në-përmbledhjen-ekzekutive-CPT/inf(2019)28) theksohet: “*Situata e pacientëve psikiatrikë në konflikt me ligjin ka qenë objekt i një dialogu të gjatë midis CPT-së dhe autoriteteve shqiptare, duke marrë parasysh që pacientët në fjalë janë mbajtur për shumë vite në kushte të papranueshme dhe me kujdes të pamjaftueshëm psikiatrik në Spitalin e Burgjeve në Tiranë dhe në Institutin e Veçantë të Zaharisë në Krujë...*”.

⁴ CPT Report 2018, faqet 7,37,38, si dhe faqja 45 “Administrimi i spitalit të ri në burgun e Lezhës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të mundësojë shërbime të specializuara për këtë

Gjetjet mbi ngecjen e punimeve në I EVP Shën Koll Lezhë, i konsiderojmë shqetësuese dhe kjo problematikë kërkon angazhimin e menjërshtë të institucioneve.

Në përmbushje të detyrimit të tij kushtetues dhe ligjor, Avokati i Popullit parashtroi gjetjet e bëra nga inspektimet në I EVP Krujë, duke ju referuar sa më poshtë vijon:

Vizitat inspektuese patën për qëllim kryesor ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga vizitat e mëparshme të Avokatit të Popullit, mbledhjen e informacionit faktik lidhur me kushtet dhe trajtimin e personave të privuar nga liria, si dhe identifikimin e rasteve të mundshme të përdorimit ndaj tyre të presionit psikologjik dhe/ ose forcës fizike tej kufijve në tejkallim të parashikimeve ligjore dhe standardeve ndërkombëtare. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të vizitave monitoruese, grupet inspektuese u takuan fillimisht me drejtuesit e institucionit, të cilët u treguan bashkëpunues në përmbushjen e qëllimit të inspektimeve. Në vijim grupi inspektues hyri në regjimin e brendshëm, ku mori kontakt me personat e trajtuar në I EVP Krujë në mjediset ku ata ndodheshin pa praninë e stafit, inspektoi objektet, pajisjet dhe mjediset e përbashkëta, mori kontakt me stafin në mjediset e tyre të punës dhe verifikoi dokumentacionet e mbajtura në regjistrat përkatës. Nga inspektimi në vend, kontakti me stafin dhe personat e privuar nga liria, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, grupi inspektues grumbulloi informacionet e nevojshme për përmbushjen e qëllimit të vizitës. Në përmbijllje të vizitave, grupi takoi sërish drejtorin e institucionit për t'i paraqitur gjetjet paraprake dhe rekomandimet që mund të zbatoheshin në vend.

I EVP Krujë ka një kapacitet zyrtar prej 190 personash. Në ditën e parë të inspektimit më datë 20.06.2019, në institucion ndodheshin 290 persona të privuar nga liria, 80 prej të cilëve ishin transferuar në I.E.V.P Krujë, si rrjedhojë e rikonstruksionit të Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (I.V.SH.B.) të filluar në prill 2019. i Në ditën e dytë të inspektimit më datë 17.12.2020 në institucion ndodheshin 284 persona, sërish në kushte të ngjashme mbipopullimi. Në të dyja inspektimet kishte mbipopullim me rreth 100 persona mbi kapacitetin.

Institucioni është i ndarë në dy sektorë A dhe B: në sektorin A, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe në shkelje flagrante të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, ditën e parë të inspektimit ndodheshin 183 persona me probleme të shëndetit mendor, për 141 prej të cilëve gjykatat kanë marrë vendim “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” në bazë të nenit 46/2 të Kodit Penal, ndërsa për 60 persona gjykatat kanë caktuar masën shtrënguese “shtrim i përkohshëm në një institucion psikiatrik” në bazë të neneve 46, 232/e dhe 239 të Kodit të Procedurës Penale. Në sektorin B ndodheshin 36 persona, kryesisht të sëmurë kronikë, persona mbi 65 vjeç dhe persona me aftësi të kufizuar. Nga të gjithë personat e privuar nga liria të trajtuar në këtë institucion, 2 ishin të mitur, 243 ishin të sëmurë kronikë nga të cilët 5 të diagnostikuar paraplegjikë, 2 me HIV AIDS, 14 diabetikë dhe pjesa tjetër me patologji të tjera ku përfshiheshin problemet e shëndetit mendor dhe të abuzimit me substanca narkotike. Situatë e ngjashme u gjet edhe në ditën e dytë të inspektimit. Të gjithë personat e trajtuar në I EVP i ishin nënshtruar check-up-it, dhe dokumentacionet ishin mbajtur në mënyrë të rregullt. Mungonte dokumentacioni për procedurat e ndjekura për eliminimin ose jo të medikamenteve të skaduar.

kategori, duke bërë të mundur aksesin e këtyre pacientëve në aktivitete kuptimplota jashtë qelive, përkujdesjen e nevojshme njerëzore dhe kontaktin me specialistë (psikiatër, psikologë, kujdestarë)”.

Struktura dhe organika e institucionit përbëhej nga 149 punonjës, prej të cilëve 101 punonjës të sigurisë dhe rolit bazë dhe 48 punonjës civilë. Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga 5 mjekë nga të cilët 2 mjekë psikiatër dhe 1 stomatolog, 1 farmacist, 11 infermierë, 4 kujdestarë. Organika e sektorit psiko-social përbëhej nga 2 psikologë dhe 2 punonjës social.

Nga inspektimet rezultoi se kishin gjetur zbatim të përkohshëm disa prej rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit, në inspektimet e mëparshme:

- a. **Ishin plotësuar vendet vakante në stafin mjekësor me 2 mjekë psikiatër.**
- b. **Ishin plotësuar vendet vakante në sektorin psiko-social me 1 psikolog dhe 1 punonjës social.**
- c. **Ishte plotësuar rekomandimi për sigurimin e ujit të pijshëm.**
- d. **Sistemi i kërkesave dhe ankimimit ishte funksional dhe administrohej nga stafi psikosocial.**

Pavarësisht disa plotësimeve, marrja e këtyre masave ishte e pamjaftueshme, se nisur nga fakti i mbipopullimit të theksuar, numëri aktual i stafit mjekësor, psikologët dhe punonjësit social ata nuk i mbulojnë dot si duhet me shërbime të gjithë të burgosurit dhe sëmuret.

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e rekomandimeve të bëra, rekomandime këto të përsëritura çdo herë nga Avokati i Popullit, nuk kishin gjetur zbatim dhe situata paraqitej si më poshtë vijon:

- **Infrastruktura e amortizuar krahas amortizimit të pajisjeve të mangëta në dhoma, lagështia si rrjedhojë e problemeve me hidroizolim, mungesa e sistemit të ngrohjes dhe e sistemit të ajrosjes, e bëjnë tepër të vështirë jetesën në këtë institucion. Shumë problematike paraqitej situata në pjesët lidhëse midis godinës së administratës dhe regjimit të brendshëm, si dhe ndërmjet sektorit A dhe sektorit B, pasi në këto pjesë, uji dhe lagështia kanë depërtuar në ambientet e poshtme të banimit në ndërtesë. Ajo çka është dhe më shqetësuese është mbajtja në të tilla kushte çnjerëzore e degraduese e të miturve dhe personave me probleme të shëndetit mendor.**
- **Mungesa e investimeve në riparime dhe materiale mbështetëse ishte e dukshme në të gjitha ambientet e regjimit të brendshëm. Brenda dhomave vërehej prani e theksuar e lagështirës dhe e mykut, mure të plasaritura dhe të palyera, papastërti e theksuar dhe prani e dukshme e insekteve, brejtësve dhe zvarranikëve. Të dënuarit gjendeshin kryesisht të shtrirë, të mbuluar me batanije të grisura dhe të palara pa çarçafë, të veshur keqas, të parruar e të paqethur. Personat paraplegjikë hasin vështirësi në përmbushjen e nevojave të higjienës veçanërisht në tualete e dushe, si pasojë e pamjaftueshmërisë së kujdestarëve si dhe e pamjaftueshmërisë së rampeve. Në përgjithësi përmbushja e kushteve për higjienë personale ishte e vështirë për t'u realizuar për shkak të numrit të madh të personave në raport me katër tualetet në sektor si dhe defekteve në dushe, problemeve me tubacionet dhe pajisjet e dëmtuara hidrosanitare.**
- **Në të dy ditët e vizitave monitoruese, problematika e përhershme e mbipopullimit u rikonstatua me përkatësisht 100 dhe 96 persona mbi**

kapacitetin zyrtar të institucionit. Për të përmbushur nevojat, institucioni ka mundësuar shtimin e shtretërve në dhoma (tip marinar), ndonëse dhomat që përpara kësaj përshtatjeje nuk i përmbushnin standardet ndërkombëtare të hapësirës së nevojshme për person. Në dhoma me sipërfaqe 12 metra katrorë strehohen 8 deri në 10 persona me mjekim të detyruar apo të dënuar, në kundërshtim me standardet minimale të pranuar nga Këshilli i Evropës percakton se çdo i dënuar duhet të ketë 4-6 metra katrorë (ose 9 metra kub) hapësirë në dhomë.

- I.E.V.P. Krujë jo vetëm që nuk mund të garantojë lëvizjet e pacientëve drejt spitaleve, apo të të paraburgosurve/dënuarve drejt gjykatave etj., por as transportin e sigurt të stafit, duke vështirësuar tej mase edhe kontaktet e familjarëve me personat që mbahen e trajtohen në të. Rruga në shpat mali që lidh IEVP Krujë me qytetin, është tejet e amortizuar dhe nuk mundëson as shkëmbimin e makinave në pjesën më të madhe të saj, duke u bërë vështirësish e kalueshme në rastet e kushteve të rënduara të motit.
- Në mungesë të dyqanit dhe të arkës në institucion, nevojat për blerje të artikujve të ndryshëm nga ana e personave të privuar nga liria mbeten të pa plotësuar.
- Mungesa e pajisjeve dhe orendive vihej re edhe në kuzhinën e institucionit ku u konstatua se pajisjet e gatimit ishin të vendosura në dysheme, në shkelje dhe mosrespektim të rregullave bazë të higjienës.
- Ambulanca e institucionit dhe krevati i fiksimit vazhdojnë të jenë tejet të amortizuar, ndërkohë që janë të pamjaftueshme mjetet e përshtatshme të kufizimit fizik (rripa lëkure, këmisha force) të domosdoshme për realizimin e imobilizimit sipas nenit 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”. Nga ana tjetër në korridoret e sektorit të shëndetësisë si dhe në korridoret ndarëse në institucion mungonin kamerat e monitorimit.
- Organizimi i aktiviteteve të nevojshme rehabilituese është i vështirë, në mos i pamundur, si pasojë e mungesës së ambienteve të përshtatshme për mundësimin e tyre. Aktiviteti punonjësve të Sektorit të Kujdesit Social kufizohej vetëm në këshillime individuale apo biseda për tema të lira në ambientet e ajrosjes.

Avokati i Popullit vlerëson se I.E.V.P. Krujë, nuk duhet të konsiderohet si një institucion i posaçëm mjekësor për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykatat kanë marrë vendim për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor” apo kanë caktuar masën shtrënguese “shtrim të përkohshëm në një institucion psikiatrik”. Mbajtja e këtyre kategorive të personave në I.E.V.P. Krujë përbën shkelje të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të tyre pasi vjen në kundërshtim me:

1. Nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku përcaktohet se të sëmurët mendorë nuk mund të diskriminohen për shkak të statusit të tyre si persona me probleme të shëndetit mendor.
2. Nenin 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: 1. *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të*

tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”.

3. Nenin 28, pika 2 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, ku përcaktohet se *“Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.*

Avokati i Popullit konstaton se me gjithë rekomandimet e përsëritura ndër vite, situata në I.E.V.P. Krujë jo vetëm që nuk përmirësohet, por vazhdon të degradohet, ndaj kërkohet vëmendja juaj e veçantë për ndërhyrje të menjëhershme me përparësi për zgjidhjen e problematikave të konstatuara. *Në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet e raportit më të fundit të CPT-së, Avokati i Popullit e konsideron të papërshtatshëm sistemimin e mundshëm qoftë dhe të përkohshëm të këtyre personave në I.E.V.P. Shën Koll Lezhë, pasi “ambientet e objektit të përkohshëm janë të dizajnuara si burg dhe se rinovimi nuk do të ndryshojë karakterin dhe mangësitë e tjera strukturore që i bëjnë këto ambiente të papërshtatshme në baza afatgjata si një institucion i kujdesit shëndetësor mendor”.*

Në dt 21 janar 2020, Shqipëria humbi një gjyq në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në rastin Strazimiri kundër Shqipërisë⁵, GJEDNj konstatoi në veçanti që kishte pasur një dështim të gjatë nga autoritetet shqiptare për të ngritur një institucion të posaçëm mjekësor për të sëmurët mendorë të cilët ishin privuar nga liria në rastet e trajtimit të detyrueshëm mjekësor të urdhëruar nga gjykata vendase.

Nga gjithë sa më sipër rezulton se:

1. Ka neglizhencë të pajustificuar nga ana e autoriteteve përgjegjëse për ngritjen e Institucionit të posaçëm mjekësor për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykatat kanë marrë vendim për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor” apo kanë caktuar masën shtrënguese “shtrim të përkohshëm në një institucion psikiatrik”, ndonëse për këtë problematikë Institucioni i Avokatit të Popullit u është drejtuar në mënyrë të përsëritur me rekomandime ministrave të drejtësisë dhe shëndetësisë. Gjithashtu kjo çështje ka zënë vend të rëndësishëm edhe në raportet vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe në raportet e veçanta të Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, të cilat i janë dërguar edhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

⁵ EHRC - Strazimiri vs Albania. The case originated in an application (no. 34602/16) against the Republic of Albania lodged with the Court under Article 34 of the Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms.

https://shqiptarja.com/uploads/ckeditor/5e26e9567be14Strasburgu%20dokument%202021%20janar_001.pdf

2. Ka neglizhencë të pajustificuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Drejtësisë për të përmbushur detyrimet ligjore në krijimin e kushteve të përshtatshme infrastrukturore dhe në sigurimin e bazës materiale të nevojshme për të garantuar respektimin e të drejtave ligjore ndaj të paraburgosurve dhe të dënuarve që trajtohen në këtë institucion. Prej vitesh, kushtet në të cilat trajtohen personat e privuar nga liria në I.E.V.P. Krujë, janë degraduese, jo humane, dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi e standardet ndërkombëtare.
3. Është e domosdoshme marrja e masave të menjëhershme nga ministria e drejtësisë për dërgimin e një letër porosie të gjitha gjykatave në shkallë vendi ku t'u silltet në vëmendje detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 46, paragrafi i parafundit i Kodit Penal, për të shqyrtuar kryesisht të gjitha vendimet e dhëna për "mjekim të detyruar në një institucion mjekësor" dhe dërgimin e vendimeve në institucionet ku trajtohen personat përkatës, ose përgatitjen e një procedure për të adresuar këtë problem në kohë.

Në përfundim, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike"*; të nenit 21, germa "b" të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, i ndryshuar, ku citohet se: *"Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 74/1 pika "b" të ligjit nr. 9888 datë 10.03.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328 datë 16.04.1998, Për të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim"* ku midis të tjerash parashikohet se: *"Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues"*.

REKOMANDOJMË:

1. **Mbylljen e Menjëhershme të I.E.V.P. Krujë, pasi kushtet e trajtimit në këtë institucion të personave të privuar nga liria janë tejet degraduese, jo humane, dhe në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor në fuqi.**
2. **Marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për sistemimin e personave me probleme të shëndetit mendor që trajtohen në I.E.V.P. Krujë në kundërshtim me ligjin, në pavijone psikiatrike që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, deri në ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore sipas përcaktimit të ligjit nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor".**
3. **Marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Drejtësisë për dërgimin e një letër - porosie të gjitha gjykatave në shkallë vendi ku t'u silltet në vëmendje detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 46, paragrafi i parafundit i**

Kodit Penal, për të shqyrtuar kryesisht të gjitha vendimet e dhëna për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor” dhe dërgimin e vendimeve në institucionet ku trajtohen personat përkatës, dhe përgatitjen e një procedure për ta adresuar këtë problematikë në kohë.

Avokati i Popullit do të përdorë të gjitha mjetet që i njeh Kushtetuta dhe ligji për të nxitur autoritetet përgjegjëse në marrjen e vendimeve dhe dhënien zgjidhje të problematikave të ngritura, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Ju bëjmë me dije se rekomandimet tona dhe përgjigjet që do të merren prej jush, do të bëhen publike, me besimin se kjo qasje do të ndihmojë në zgjidhjen në kohë të problematikave.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA

Drejtuar :